

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Sherbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS : “Mirembajtje e Njesive Operacionale te I.T.U.N, Çuke, perfshire pompat, pajisje, materiale etj.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) : Sherbime per riparimin dhe mirembajtjen e pompave

VLERA E FONDIT LIMIT : 11 200 000(njembëdhjetemilion e dyqind mije) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Sh.A Sarandë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga

vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e perllorarit e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. (neni 43, pika 2, germa ”b” VKM nr. 285, datë 19.05.2021)

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 të konfirmuara nga administrata tatimore, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë sa 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën sa 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës..

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2. Licenca profesionale të operatorit ekonomik për realizimin e objekti të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

Operatorët ekonomik duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën perkatese të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Punime të pergjithshme:

- **NP-7 A – Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje.**
- **NP-11 B-Ndertime te n/s kabinat e trasformatoreve dhe shperndarjen e energjise**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P 7	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje.	Sherbime ne Ujesjelles dhe stacionet epompave ne ITU.N	A	0-20 milion leke
NP-11	Ndertime te n/s kabinat e trasformatoreve dhe shperndarjen e energjise	Sherbime ne Panelet elektrike te stacioneve te pompave ne ITU.N	A	0-20 milion leke

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, për të përmbushur këto kriter duhet të paraqesi konkretisht:

- a) - Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj (**ose ekuivalente**) (e vlefshme), **ku të përcaktohet fusha e aktivitet të OE, lidhur me tipologjin e kontratës të prokuruar nga AK.**

- b) Çertifikatën e menaxhimit Mjedisor ISO 14001-2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalentin e saj (**ose ekuivalente**) (e vlefshme).
- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, mbi “Shëndetin dhe siguria në punë”, ose ekuivalentin e saj (**ose ekuivalente**) (e vlefshme).
- d) Çertifikatën ISO 3834-2:2006 mbi “Kërkesat e cilësisë për saldimitin e materialve metalike”, ose ekuivalentin e saj (**ose ekuivalente**) (e vlefshme).

(Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë Certifikate kërkuara sipas pikës 2.3.3 të vlefshme).

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, citon: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Një. P vëndosi të kërkojë certifikatat e mësipërme për të vërtetuar cilësinë e shërbimeve që do të kryen nga O.E fitues. Certifikatat e kërkuara janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe respektojnë parimin e mosdiskriminimit.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij të paktën një **Inxhinier Elektrik si Drejtues Teknik.**
- Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij të paktën një **Inxhinier Mekanik si Drejtues Teknik.**
- Për plotësimin e kësaj kërkesë, Ofertuesi duhet të dorëzojë
 - CV ku të pasqyrohet eksperiencia e punës jo më pak se 1 vitë inxhinierëve të kërkuar.
 - Diplome të Inxhinierit Elektrike, Inxhinierit Mekanik.
 - Kontratë noteriale pune lidhur ndërmjet shoqërisë ofertuese dhe punonjësit të kualifikuar

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislativi për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të përmbushjes të shërbimeve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar mesatarisht të paktën **10 persona**, për periudhën **Gusht – Tetor 2022** të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen **Gusht – Tetor 2022**
- List-pagesat e punonjesve, shoqeruar me Formularet e Deklarimit te Pageses se Sigurimeve Shoqerore per Periudhen e me sipërme, te konfirmuar nga Administrata tatimore.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e shërbimve si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhe te paraqesi per stafin e tij Teknik:

1. Manovrator 1 (personel)

2. Elektracist 2 (personel)

3. Mekanik 2 (personel)

- Te gjithë punonjesit duhet te jene te certifikuar me **“Deshmi te Kualifikimit e Sigurimit Teknik”** leshuar nga institucione te akredituara vendore ose nderkombetare.

(Per stafin e me siperm te paraqitet kontrata e punes e vlefshme brenda afatit te realizimit te kontrates **“Deshmi te Kualifikimit e Sigurimit Teknik”** leshuar nga institucione te akredituara vendore ose nderkombetare, si dhe te figurojne ne listepagesat per periudhen e kerkuar ne piken 2.3.4).

(Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te dorezoje dokumentacion per stafin teknik ne baze te % te marre persiper per realizimin e punimeve ne Objektin e Prokuruar).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- Numri i fuqise punentore u llogarite duke u bazuar ne numrin e personelit te grupit te punes qe munde te punojne per permbushjen e shërbimit te kerkuar gjate nje periudhe prej 365 ditë, ky numer perkon dhe me kerkesen e personelit ne pikat e mesiperme

- Njesia e Prokurimit (specialisti i fushes) vlerëson se te pakten 7 punonjes duhet te jene pajisur me me kartela personale te sigurimit teknik, te leshurara nga Inspektoriati Qendror Teknik ose nga organi kompetent ne baze te ligjit nr. 8734, date 01.02.2001 dhe ligjit Nr.13/2013, date 14.02.2013, nga te cilet te pakten 10 (dhjete) të jenë elektracist dhe me deshmime perkatase te formimit. Keto deshmi duhet te kerkohen per shkak te natyres se shërbimeve, punonjesit duhet të kenë njohuri të plota mbi elektroteknikën, njohuri të plota të Rregullores së Sigurimit Teknik Elektrik, mbi rregullat e përdorimit të mjeteve mbrojtëse që përdoren në linjat elektrike. Gjithashtu të kenë njohuri mbi impiantet elektrike (linjën elektrike), që të jenë të aftë nëpër caktimin, se cilat elemente duhet të hapen për kryerjen e punimeve, dhe të dijë të veprojë në zbatimin e masave të domosdoshme të sigurimit teknik elektrik.

- Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek oret maximale të punës që duhen për permbushje të shërbimit dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të permbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje , (Gusht 2022 – Tetor2022), tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën.

- Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektivit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

- Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë në **pronesi ose me qera** makineritë dhe pajisjet e mëposhtme: (të vërtetuara me fatura tatimore blerjeje ose kontrate qiraje me afat deri në realizimin e plotë të kontratës).

1. Bobinatrice për avolzhime elektromotoresh.	1 cope
2. Tronkatrice për prerjen e nukleve 45 °.	1 cope
3. Mjet ngrites pirun deri në 2.5 ton.	1 cope
4. Vinxh elektrik deri në 2.5 ton të montuar në repart.	1 cope
5. Komion me Vinc, ngarkes të ganxhes minimale 1 ton.	1 cope
6. Autokosh për punime në lartësi.	1 cope
7. Aparat “MEGER” për matje pershtjellash.	1 cope
8. Aparat “AmperMeter” për matje të impulsive elektrike etj.	1cope
9. Set veglash pune dhe Mbrojtje Personeli	5 cope

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

a) dokumenti që vërteton pronesinë e mjetit;

b) leje qarkullimi;

c) certifikatën e kontrollit teknik;

d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);

e) certifikatën për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme), taksat.

Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet:

a) dokumenti që vërteton pronesinë e tij;

- b) leje qarkullimi;
- c)çertifikaten e kontrollit teknik,
- d)siguracionin e mjetit,(i vlefshmëm);
- e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme), taksa.

Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerase/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- a) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë, vlevshmeria e te ciles duhet te perfshije te gjithë periudhen e realizimit te punimeve.
- b) Operatori ekonomik duhet të **paraqesë foto për secilin mjet dhe paisje** të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike që në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar sherbimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve per permbushjen e sherbimit, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetete të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët.Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.8 Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar, per kitet e kerkuara te pompave “**FLYGT**” ose **ekuivalente me to**, qe verteton se pjeset e kembimit permbushin specifikimet teknike te ketyre njesive apo pajisjeve (perfshire dhe pompat) e kerkuara sipas preventivit te hartuar nga AK, ose **jane ekuivalente** me njesit dhe pajisjet ne fjale.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet në varësi të objektit që prokurohet, të cilinin AK e vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kerkesa për paraqitjen e Autorizimi të me sipërme për furnizimin me kate për njeisite operacionale apo pajisjet në fjalë, është një kerkese e lidhur ngushtesisht me objektin e kontratës dhe duke qenë se, Autoriteti Kontraktor është përfitues direkt i kontratës objekt prokurimi është në të drejtën e tij të garantohet se OE- të pjesëmarrës të plotësojnë kërkesat e cilesive të mallit duke ofruar produkte të njëjësive apo pajisjeve objekt prokurimi sipas specifikimeve teknike të tyre të përcaktuara në preventivin e hartuar apo ekuivalente me to. Kërkesa e mesipërme ka si qëllim të sigurojë AK-ne, mbi aftësitë teknike të OE fitues në drejtim të përmbushjes me sukses të kontratës dhe detyrimeve në zbatim të saj, konform standarteve të mirepërcaktuara në DST. Ky kriter nuk është diskriminues dhe është proporcional me objektin e kontratës, si dhe është në zbatim të Nenit 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.9 Operatori ekonomik të ketë “**Ambient/Njeshi Sherbimi**” i cili të disponojë hapësirat e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate, me sipërfaqe minimum 200 m², kjo e vertetuar me kontratë qeraje apo certikatat pronësie.

Për të plotësuar këtë kriter, Operatori ekonomik të paraqesi **foto** të Repartit ku do të kryhen punimet. Reparti mund të jetë dhe me “Qera”, por gjithmone kontrata e “Qeras” duhet të jetë i vlefshëm për një periudhë, sa periudha e përmbushjes së kontratës objekt prokurimi nga OE, përcatuar në dokumenta të tenderit.

(Nëse oferta është BOE, është e mjaftueshme që një nga OE e bashkimit të paraqesi dokumentacion për plotësimin e pikës **2.3.9**).

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të ketë repart servisi, ku të realizohet **demontimi i njesive apo pajisjeve, prova mekanike dhe elektrike, si dhe avolzhim elektromotorash**, repartit të shoqërohet me foto të pajisjeve dhe aparatave që realizojnë shërbimet e me sipërme, si dhe të jetë i certifikuar ose regjistruar pranë autoriteteve kompetente për realizimin e këtyre shërbimeve.

-Ose kontratë bashkepunimi me një OE të dyte, ku ky OE të jetë i specializuar për realizimin e këtij objekti. Periudha e kontratës së bashkepunimit duhet të jetë brenda afatit të realizimit të përmbushjes të kontratës për objektin të prokuruar nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, mjetet dhe ambientet e nevojshëm, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Konkretisht:

- Ky kriter i jep mundësi Autoritetin Kontraktor, që pas lidhjes së kontratës me OE, të ketë një garanci me shumë mbi vendodhjen dhe ruajtjen e paisjeve apo njesive operacionale të percaktuara në preventive, si dhe reparti ku këto do të neshtrahet kontrollit teknik dhe riparimit të defekteve në mënyrë që përmbushje e kontratës të jetë zgjidhje efiçente për mirëmbajtjen e Impianti të Trajtimit të Ujrave të Ndotura.
- Sipërfaqja e Repartit apo njesisë të shërbimit prej 200 m², do të na japë mundësi që nëse do të kemi disa pajisje të defektuar apo dhe pajisje të tjera që ndodhen në repart, të jenë të aksesueshme nga mjetet e ngritjes dhe personeli që do të kontrollojë dhe riparojë defektet e njesive operacionale apo pajisjeve.
- Reparti i servisit, i zotëruar nga OE, për demontimin e pajisjeve apo njesive operacionale, riparimin dhe avolzhimin e elektromotoreve të tyre, është një domosdoshmëri e pa negociueshme për përmbushjen me sukses të kontratës të prokuruar nga AK, dhe perfundimin e procedurave nga konstatimi i defektit tek riparimi, instalimi dhe vendosja në punë me kapacitet të plote të njesive operacionale apo pajisjeve.

2.3.11 Mallart e furnizuara, pjesë e preventivit të hartuar nga AK, duhet të jenë reja si edhe të kenë garanci përdorimi, jo më pak se **12 muaj** nga marrja e tyre në dorëzim. Mallart duhet të jenë të shoqëruara me kataloget perkatese të prodhuesit dhe certifikat origjinale, ku të vertetohet se mallart përmbushin specifikimet teknike të njesive apo pajisjeve si dhe të regjistrohen në Bashkimin Europian me targetin “CE”.

Argumentim: Kriteri i kërkuar në lidhje me përmbushjen e Garancisë 12 mujore të mallrave dhe katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 3, të Nenit 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ne plotësim të kësaj kërkesë, Ofertuesi duhet të dorëzojë një Deklaratë ku të deklarojë se mallart e ofertuar në preventive do të jenë konformë kërkesave dhe kushteve të këtij kriteri.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

1. Informacion mbi stacionet e pompimit, njesit operacionale për sektore të ndryshëm trajtimi si dhe vendodhjen e tyre I.T.U.N.

Impianti I trajtimit të ujrave të ndotura ndodhet i pozicionuar në jug-lindje të qytetit të Sarandës, në fushat e Vurgut. Siç do të neshtrahet nga njesit operacionale për rikarkullimin, ngritjen dhe levisjen e ujit në hallka të vecanta për të arritur parametrat e kërkuar, dhe impianti i trajtimit të ujrave të ndotur ndërtohet nga sisteme të ngritjes mekanike apo sisteme levizese për rikarkullim të ujit të ndotur.

Jane gjithsej 4 stacione kryesore pompimi per levizjen e ujit ne per sektore te ndryshem trajtimi si dhe pompimin e tij ne drejtimi te basenit uje prites me te afert lumi Bistrica. Stacioni Inlet i cili perbehet nga 3 pompa, arine te grumbulloje sasin e nevojshme te ujrave qe vine nga qyteti i Sarandes dhe qyteza e Ksamilit, si dhe e pompon keto ujra te pa trajtuar, per ne procesin e trajtimit paraprak. Stacioni i ndermejetem perbehet nga 3 pompa, dhe arine te grumbulloje sasin e ujrave te cilat kane kaluar proceset e trajtimit primare dhe ate biologjik, duke e pompuar kete sasi uji ne drejtim te stacionit fundore te klorinimit. Stacioni Outlet perbehet nga 3 pompa, te cilat arijne te zhvendosin te gjitha ujrat e gjeneruar nga trajtimi i Impiantit, dhe pompimin e tyre ne drejtim te lumit Bistrica. Stacioni i riqarkullimit te ujrave te drenuar nga depozitimi i llumrave te gjeneruar ne pondet e ajeruara, perbehet nga 2 pompa te cilat pompojne ujin e grumbulluar te drenazhit te vaskave te tharjes se llumit, ne drejtim te kullës shperndarese per pondet e ajeruara. Ne keto stacione, ashtu sic eshte pershkruar edhe ne preventiv, jane te instaluar pompa zhytесе (stacione qetsimi) verikale (ne stacione mbeshtetes). Pompat jane te llojeve dhe markave te ndryshme si “FLYGET”. Sistem tjetër me ngritje mekanike eshte dhe sitemi i zhvendosjes se llumrave te cilat gjenerohen ne pondet e ajeruara. Gjithesej kemi tre stacione te zhvendosje se llumrave , nga 1 per secalin ponde, ne te cilat jane instaluar pompa horizontale me boshte me gunga. LLoji I pompave te instaluar ne per keto stacione eshte “BELLIN”.

Per aritjen e parametrave te kerukar te ndotsave qe permbajen ujrat e ndoture, ne Impiant kemi te instaluar dhe njesi te tjera operationale te cilat ndihmojne proceset e tajtimit te ujrave te ndoture, duke larguar, zhvendosur, ajeruar dhe koagulluar keto ujra, nga ndotesit qe keto ujra permbajne. Per njesite ne fjale, me specifikisht, per modelin dhe teknologjin do te trajtohet ne preventivine hartuar nga dega teknike. Stacionet e pompimit jane relavisht te rinj, Impianti ka perfunduar ne vitin 2013. Sigurisht, qe gjate kesaj kohe qe ka qene ne funksionim, nuk eshte aritur te behet nje mirembajtje preventive ne keto sisteme te impiantit, por vetem mirembajtje te zakonshme per nevoja emergjente qe kane lindur gjate funksionimit te tyre. Kjo eshte nje nga arsyet qe per kete perudhe kaq te shkurter, sistemet po degradojne dhe po shfaqin gjithenje e me shume probleme teknike.

2.Kategorite e punimeve

Punimet qe do te kryhen, per mirembajtjen dhe riparimin e elektropompave, jane dy llojesh;

Punime mekanike qe perfshijne riparimin dhe mirembajtjen e pompave.

Me konkretisht, ne keto punime perfshihen;

Çmontimi i pompes nga bazamenti ose nxjerrje nga pusi,transport ne piken e servisit, demontim i vete pompes, riparim ose zevendesim i pjeses se demtuar (kushinete, bosht, permistop, bokoll, distancator, difuzor, elike, Stator, Rotor etj), montim i pompes, risjelleje ne stacion dhe futje ne bazament .

Pervec ketyre, perfshihen edhe disa punime te tjera te mirembajtjes prventivuese, si gratatime kushinetash ose lubrifikim me vaj, sipas rastit, shtrengime bulonash, etj, e cila do te percaktohet ne preventive sipas manualit te operimt dhe mirembajtjes te njesise.

Punime elektrike, qe perfshijne riparimin dhe mirembajtjen e elektromotoreve.

Edhe per punimet elektrike, do te ndiqet i njeiti proces pune si per pompat, por per elektromotoret, eshte parashikuar kryesisht avolzrimi (ripeshtjellimi) i tyre dhe, ne disa raste, edhe zevendesimi i pjeseve te tjera te kembimit, si kushineta, permistopa, boshte etj.

Punimet qe do te kryhen, per mirembajtjen e njesive te sistemeve operationale , jane dy llojesh:

Punime mekanike qe perfshijne riparimin dhe mirembajtjen e gjithe pajisjes ne fjale si :

Ventilatoret, Grilat automatike, Kompresoret e ajerit, Desander, sitemi I zhvendosjes se mberurinave etj.

Si dhe punime elektike per riparimin dhe mirmbajtjen e elektromotoreve te ketyre njesive.

3.Preventivi dhe te dhena te tjera teknike

Ne preventivin e hartuar per realizimin e kesaj procedure prokurimi percaktohen; marka dhe tipi I pompes, njesise operacionale si dhe elektromotorat perkates, numrat e pompave dhe marka e prodhimit per cdo pajisje.

Ne preventiv jane te perfshira edhe punimet shtese si, demontim dhe montim i pajisjes (nxjerrje dhe rifutje ne stacion), transport deri ne piken e servisit dhe risjellje, per cdo sherbim qe do te kryhet dhe do t'i kete te nevojshme keto punime.

Ne preventiv jane paraqitur punimet dhe pjeset e kembimit, qe mund te nevojiten per nje elektropompe , te cdo marke ose te cdo stacioni pompimi, por Autoriteti Kontraktor, ka te drejte, qe te riparoje me shume se nje pompe te se njejtës marke apo dhe njesi operacional, mjafon qe ky punim te kryhet ne baze se vlerse se ofertuar per riparimin e kesaj pompe dhe vlera totale e punimeve ne asnje rast te mos e kaloje vleren totale te kontrates.

Ne preventive do te percaktojm per cdo njesi qe do te prokurohet, dhe sherbimin perkates preventivues i cili do te jete i percaktuar ne kohe sipas manualit teknik te mirembajtjes. Cmimi per kete sherbim do te vendoset si cmim njesi per per 1 sherbim, dhe do te merret si cmim reference te sherbimeve ditore te realizuara nga shoqeria jone dhe/ose si cmim reference nga mesatarja e ofertave te operatoreve qe sherbejn ne kete sktoer te tregut.

Produketet e kerkuara ne preventivin e hartuar, duhet te permbushin specifikimet teknike te njesie operacionale ose pajisjes ne fjale, si dhe ne ansje raste nuk perjashtohen produktet **ekuivalente me to** te cilat permbushin specifikimet teknike sipas percaktimeve te llojit dhe tipit te produktit.

Lubrifikantet qe do te perdoren per pompat zhytесе te largimit te ujrave te ndotura si dhe per pikat e grasatimit te njsive operacionale, do te jene vajra jo toksike tip Mercury No; 7174,Merkur White oil Pharma 40 ose ekuivalent SAE 10W, SAE 20W dhe graso ESSO UNIRES N3, FAG ARCANOL L40,TEXACO HYTEC EP3/DEA, **ekuivalente me to**. Pragon ose Gançat e vincurave duhet te jene te specifikuar ne lejet e qarkullimit te mjetit, te cilat do bejn zhvendosjen e njesive si dhe ngritjen dhe uljen nga stacioni, .

4.Sqarime dhe detyrime per operatorin ekonomik

Operatori ekonomik ose ofertuesi, kur te paraqese oferten e tij, duhet te kete parasysh se, cdo ze punimesh , qe do te kryhet, ne rastet kur do te kerkoje zevendesim te pjeseve te demtuara, eshte furnizim dhe vendosje e kesaj pjese, prandaj zeri i **punetorise(hak pune)**,nuk do te paraqitet me vete ne preventiv.

Nga ana tjeter, operatoret ekonomike, qe do te marrin pjese ne konkurim, duhet t'a kene te qarte se, meqenese kemi te bejme me nje procedure konkurimi, qe do t'i paraprije nje **marreveshjeje kuader**, Autoriteti Kontraktor nuk eshte i detyruar te kryeje cdo punim sipas zerave te preventivit, dhe te paguaje te gjithë vleren limit te kontrates. Ne cdo rast, autoriteti kontraktor do te paguaje operatorin ekonomik, per ato pune, sherbime, riparime, apo zvendesime me pjese te reja qe do te ndodhin faktikisht.

Sherbimi periodik apo profilaktik, do te realizohet nga Operatori cdo periudhe kohe, e cila nise qe nga momenti i neshkrimit te kontrates me Autoritetin Kontraktor, nese nje pajisje kerkon (Psh. cdo 2 muaj kontroll teknik sipas manualit te mirembajtjes), ateher pajisja sipas percaktimeve ne preventivin e hartuar nga AK, do ti neshthrohet nje kontrolli te imtesishem mekanik dhe elektrik, per ti paraprir dhe parandaluar difektet me te renda te mundeshme te njesise apo pajisjes.

Operatori ekonomik, eshte i detyruar te kryeje me cilesi te larte dhe ne kohe, cdo punim, qe do t'i kerkoje autoriteti kontraktor, sipas zerave te punimeve ne preventiv, brenda vleres limit per cdo ze(njesi),qe operatori ekonomik, ka ofertuar.

Operatori ekonomik, është i detyruar që punimin, që autoriteti kontraktot do të kerkoj, ta realizojë në prani të stafit operues të Impiantit si dhe të japë instruksione dhe udhëzime për mirëmbajtjen e njesisë apo pajisjes në fjalë.

Për çdo punim (riparim) të kryer, operatori ekonomik duhet të leshojë një certificate garancie, me afat jo më të vogël se një vit, nga data e dorëzimit perfundimtar të shërbimit. Çdo defekt që do të ndodhë në pajisjen e riparuar, brenda periudhës së garancisë, do të riparohet nga operatori ekonomik (me vonë kontraktuesi), me shpenzimet e tij.

Operatori ekonomik, duhet të marrë masa që, çdo pjesë këmbimi, të percaktuar në preventiv, në baze të markes, tipit, apo numrit të pajisjes, të jete në gjendje t'ua sigurojë sa më shpejt të jete e mundshme. Cilesia e pjesëve të këmbimit, të shoqërohet me broshurë dhe certifikat produkti, që për pjesët e montuar në njësi të kuptohet se janë të satandartit me të lart dhe tregetohen në Bashkimin Europian. Mos pasja apo mos sigurimi në kohë të njërës apo disa pjesëve të këmbimit, do të sjellë vonesa të pajustificueshme për riparimin e agregatit dhe si rrjedhim edhe të punës normale të njesive operacionale, aq të domosdoshme, të I.T.U.N. Në rast se ndodhë kjo problematik, do të behet shkak për zgjidhjen e njëanshme të kontratës nga AK .

5. Praktika e punimeve

Shërbimi preventivues ose profilaktik nga OE, do të realizohet sispas percaktimeve në preventivin e hartuar nga AK. Periudha kohore e kontrollit të njesive apo pajisjeve do të respektohet në mënyrë rigorozë dhe do të nisë që nga momenti i nëshkrimit të kontratës. Gjate kësaj shërbimi do të marrin pjesë grupi i punës i ngritur nga AK si dhe personeli i specializuar i OE. Për këtë shërbimi do të hartohet një Procesverbal Konstitimi ku të shënohen të gjitha të dhënat dhe parametrat e matura apo të diktuar të njesive operacionale apo pajisje. Ky shërbim do të shënohet në një regjister kalendrik, nga ku do të fillojë koha për parashikimin e konstatimit të dytë si dhe marrjen e masave paraprake. Në rast se gjate konstatimit lindë nevojë që njesia apo pajisja të nështrohet një kontrolli me të imtesishem teknik në repartin e OE, atëherë për paraktin e punës, AK dhe OE do të ndijekin hapat si më poshtë për të zgjidhur problemin dhe për të perfunduar procedurat e riparimit.

Operatori ekonomik (kontraktuesi), do të njoftohet zyrtarisht (bejne përjashtim rastet, që do të konsiderohen emergjente nga Autoriteti Kontraktor) për defektin dhe pa humbur kohë do të paraqitet me specialistet e tij pranë stacionit që do të ketë problem. Pas konstatimit, konfirmimit të defektit, nga të dyja palët, për specialistet e tij dhe tanët, agregati i demtuar do të dorëzohet operatorit, me anë të një akti dorëzimi ose flete daljeje provizore.

Operatori ekonomik (me vonë kontraktuesi), pasi t'ua verifikojë me në thellesë defektin, duke e zmontuar agregatin në piken e tij të servisit, do të dërgojë Autoritetit Kontraktor, një raport të hollësisht teknik, ku të përshkruhen në mënyrë të detajuar defektet e ndodhura dhe sipas tij, arsyesen përse kanë ndodhur dhe se bashku me të një preventiv-offerte, për punimet dhe pjesët e këmbimit të nevojshme për riparim, duke iu përmbajtur rigorozisht, kushteve të parashikuara në kontratë.

Pasi Autoriteti Kontraktor, t'ua ketë miratuar këtë shërbim, operatori do të vazhdojë punë, për riparimin e defektit, sipas afatit të paracaktuar. Pas perfundimit të riparimit, operatori do të kryejë testimet e nevojshme, të cilat, do të ia paraqesë edhe Autoritetit Kontraktor dhe do të montojë pajisjen në stacion. Agregati ose pajisja do të punojë në periudhë prove për 72 orë, dhe pas kësaj, do të merret në dorëzim, me një garanci, të paktën një vjeçare.

Autoriteti kontraktor ne cdo rast do te caktoje nje grupe pune, nga stafi i impiantit apo dega elektromekanike, per te mare pjese gjate sherbimeve preventivuese dhe riparimit, ne menyre qe stafi te njihet me informacionin dhe udhezimete duhura per mirmbajtjen e pajisjeve

Per te gjitha keto hapa, qe pershkruam me lart, autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik (kontraktuesi) do te plotesojne nje dokumentacion ose regjistri, i cili do te pershkruhet me hollesisht ne kontrate.

Ne rastet qe, do te konsiderohen emergjente nga Autoriteti Kontraktor, prioritet do t'i jepet zgjidhjes sa me shpejt te problemit, perkunder dokumentimit rigoroz te proceseve qe pershkruam me siper. Por, sidoqofte, edhe ne keto raste, per aq sa eshte e mundur, do te mbahet nje dokumentacion, i cili te deshmoje punen e kryer.

6. Cilesia e mallrave te sherbimeve

Mallrat e shrebimeve duhet te shoqerohen me broshuren perkatese te perkthyer ne shqipe dhe te jene te certifikuar me etiketen "CE" te percaktuar si produkte qe tregtohen ne tregun e Bashkimit Europian. Mallart duhet te pershtaten me njesite operationale si dhe te **permbushin specifikimet teknike** te cdo njesie apo pajisje, sipas markes dhe tipit te pershkruara ne preventivin e hartuar, duke mos perjashtuar ne asnje raste produktet **ekuivalente me to, te cilat rivitalizojn aftesine teknike dhe risin** eficencen e energjise te njesise operationale apo pajisjes ne fjale.

7. Afati i punimeve

Afati i kesaj marreveshjeje , do te jete **2 (dy vjecar)**, pra, per dy vite, nga data e lidhjes se kontrates, operatori ekonomik fitues, do te jete pergjegjes per mirembajtjen e njesive operationale, sipas kushteve te parashkruara ne preventiv dhe specifikime teknike. Ndersa afati i kontratave qe do te lidhen, bazuar ne kete marreveshje, do te vendoset ne varesi te sherbimeve preventivuese, per mirembajtjen e njesive dhe riparimin e defektit(eve) per cdo rast, ne varesi te rendesise teknologjike, qe ka stacioni i pompimit apo njesia operationale (motoredaktor apo electromotor), njesi e cila eshte defektuar, njesi te tjera te demetuara apo edhe ne varesi te periudhes kohore (sezoni veror) ne te cilin munde te ndodh defekti (perben emergjence).

Më pas u vendos për këto çështje:

Vlefshmëria e ofertës 150 ditë.

Kriteret e vlerësimit: Është çmimi më i ulët i ofruar.

Afatet e ekzekutimit, janë 24 muaj, nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

Komisioni unanimisht bëri miratimin e tyre dhe u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave, në Sistemin Elektronik.

NJESIA E PROKURIMIT

ANILA VJERI

FATJON BEQIRAJ

ALGERT BAJRAMI